



KOMPANIA RAJONALE UJËS JELLËSI SH.A
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVODI D.D
MITROVICA
TEL/FAX: +383 767, 520-304

Nr. 01-705

Data: 02.05.2023

Kompania Rajonale e Ujit

"Mitrovica" SH.A.,

**Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit të Pavarur
31 dhjetor 2022**



KOMPANIA RAJONALE E LITË
 REGIONAL WATER COMPANY LLC
 KOMPANIA E TË HAMBURIT VIKTORI B.D.
 MITROVICA
 TIRANE, RRETHI I TIRANES, RROG. 204
 01-70-50
 01-70-50

PËRMBAJTJA

	FAQE
RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	8
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	9
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	10
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	11
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	12 – 28

Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit të Pavarur
 31 dhjetor 2022

KOMPANIA RAJONALE E LITË
 REGIONAL WATER COMPANY LLC
 KOMPANIA E TË HAMBURIT VIKTORI B.D.
 MITROVICA
 TIRANE, RRETHI I TIRANES, RROG. 204
 01-70-50
 01-70-50



RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

Drejtuar: Menaxhmentit dhe Bordit të Kompanisë Rajonale te Ujit Mitrovica sh.a

Raport mbi Pasqyrat Financiare

Mohim i Opinionit

Ne nuk shprehim një opinion mbi pasqyrat financiare përcjellëse të kompanisë. Për shkak të rëndësisë së çështjeve të trajtuara në seksionin Bazat për Mohim të Opinionit të raportit tonë, ne nuk kemi qenë në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi të përshtatshme për të siguruar një bazë për një opinion të auditimit për këto pasqyrat financiare.

Baza për mohim të opinionit

1. Siç është shpalosur me tutje në shënimin 5 te pasqyrave financiare përcjellëse, vlera e Prones, Impianteve dhe Pajimeve të Kompanisë me 31 Dhjetor 2022 është 24,162,675 EUR (31 Dhjetor 2021; 26,531,643 EUR). Kompania ka rivlerësuar vlerën e Prones, Impianteve dhe Pajimeve në vitin 2007 dhe nga ai vite asetet e kompanisë nuk janë rivlerësuar me tutje, prandaj, ne nuk ishim në gjendje, duke aplikuar procedurat standarde dhe alternative të auditimit, të përcaktonim nëse vlera e prezantuar e Prones, Impianteve dhe Pajimeve duhet të korrigjohet për efektet e rivlerësimit në vlerën e ashtu siç kërkohej me Standardin Nderkombëtar të Kontabilitetit 16, Prona, Impiantet dhe Pajimet.
2. Siç është shpalosur me tutje në shënimin 6 te pasqyrave financiare përcjellëse, gjendja e llogarive të arkëtueshme tregtare dhe të tjera të Kompanisë me 31 Dhjetor 2022 është 25,871,367 EUR (31 Dhjetor 2021; 24,783,897 EUR). Ne mungese të konfirmimeve nga palet e treta dhe në pamundësi për të aplikuar procedurat tjera të auditimit, ne nuk ishim në gjendje të përcaktonim nëse ishin të nevojshme rregullimet e në vlerën bartese të llogarive të arkëtueshme apo shpenzimet për borxhe të kqija të njohura me 31 Dhjetor 2022 dhe 2021. Për më tepër Kompania nuk ka një metodologji të adaptuar në përputhje të plot me SNRF 9. Prandaj, ne nuk ishim në gjendje të përcaktonim nëse ishin të nevojshme rregullimet e në vlerën bartese të llogarive të arkëtueshme apo shpenzimet për borxhe të kqija të njohura.
3. Kompania nuk ka njohur detyrimet/asetet për tatimin e shtyre në pasqyrën e Pozites financiare dhe as efektet vejtore në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Pas Parasysh natyrën e shënimeve që mban Kompania në e kishim të pamundur të përcaktonim nivelin e korrigjimeve në lidhje me njohjen e tatimeve të shtyra ashtu siç kërkohej me SNK 12 Tatimet.
4. Siç është shpalosur me tutje në shënimin 10 te pasqyrave financiare përcjellëse, gjendja Granteve të shtyra për asete me 31 Dhjetor 2022 është 17,900,881 EUR (31 Dhjetor 2021; 19,156,437 EUR). Pas parasysh natyrën e shënimeve që mban Kompania dhe në pamundësi për të aplikuar procedurat tjera të auditimit, ne nuk ishim në gjendje të përcaktonim nëse ishin të nevojshme rregullimet e në vlerën e granteve të shtyra me 31 Dhjetor 2022 dhe 2021.
5. Siç është shpalosur me tutje në shënimin 9 te pasqyrave financiare përcjellëse, gjendja Llogarive të pagueshme dhe të tjera me 31 Dhjetor 2022 është 5,046,592 EUR (31



Dhjetor 2021; 5,223,238 EUR). Ne nuk kemi pranuar konfirmimet nga palet e treta ne vlere 3,601,708 EURO,(të pagueshmeve për TVSh ndaj ATK-se) prandaj ne nuk ishëm në gjendje të arrijmë një siguri të arsyeshme për vlerën bartëse të të pagueshmeve tregtare të kompanisë më 31 Dhjetor 2022 për vlerën 3,601,708 EURO (31 Dhjetor 2021; 3,758,493 EUR).

6. Pasqyrat financiare nuk përfshijnë të gjitha shpalosjet e kerkuara me SNRF 9 Instrumentet Financiare, SNRF 15 Te hyrat nga Kontratat me Kliente dhe SNRF 7 Instrumentet Financiare, Dhenia e informacioneve shpjeguese.
7. Siç është shpalosur me tutje në shënimin 22 të pasqyrave financiare përcjellëse, menaxhmenti nuk ka njohur ndonjë provizion në lidhje me rastet gjyqësore për paditë e ushtruara ndaj Kompanisë. Ne mungese të vlerësimeve nga menaxhmenti ne e kishim të pamundur të përcaktim vlerën e provizioneve të nevojshme që do duhej të njiheshin në datën e raportimit apo efektin e tyre në pasqyrat financiare me 31 Dhjetor 2022 dhe 31 Dhjetor 2021.

Theksim i çështjes

Siç është shpalosur në shënimin 19 të pasqyrave financiare përcjellëse, librat dhe regjistrimet tatimore të Kompanisë nuk janë audituar nga Autoriteti tatimor për vitin që përfundon që 31 Dhjetor 2022. Si rrjedhojë e kësaj, detyrimet tatimore të Kompanisë nuk mund të konsiderohen të finalizuara. Provizionet për taksat shtesë dhe gjobat, nëse ka ndonjë, nuk mund të përcaktohen me ndonjë saktësi të arsyeshme, në këtë fazë.

Cështje tjera

Pasqyra financiare të kompanisë për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2021 janë audituar nga Auditori tjetër opinioni i të cileve mbi keto pasqyra ka qenë opinion i kualifikuar për Pronen, Impiantet dhe Pajimet, Llogarite e arketueshme dhe demitimi i tyre, vlerësimi i sqoteve dhe Llogarite e pagueshme.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare individuale

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së kompanisë për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitetit sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Kompaninë ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.



Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare individuale

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi, dhe për të nxjerrë raportin e një auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticismin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ne gjithashtu, ju japim personave të ngarkuar me qeverisjen një deklaratë që ne jemi në pajtim me kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe ju komunikojmë atyre të gjitha lidhjet dhe çështjet e tjera që mundet në mënyrë të arsyeshme, të ndikojnë në pavarësinë tonë, dhe kur është e zbatueshme, masat mbrojtëse përkatëse.



Informatat tjera

Informatat tjera përfshijnë Raportin e menaxhmentit, se bashku me një Deklaratë të qeverisjes Korporative të Organizatës ashtu siç kërkohet nga neni 7 i Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, të cilat përbejnë pjesë të veçantë të raportit për vitin financiar që përfundon me 31 Dhjetor 2022.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për informatat tjera

Menaxhmenti i kompanisë është përgjegjës për informatat tjera. Informatat tjera përfshijnë raportin e menaxhmentit të përfshirë në raportin vjetor.

Përgjegjësitë e auditorit

Mendimi ynë për pasqyrat financiare nuk përfshin informacione të tjera dhe, përveç në masën e deklaruar në mënyrë të shprehur në raportin tonë, ne nuk shprehim ndonjë konkluzion sigurie në të.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është që të lexojmë informacionin tjetër, dhe duke vepruar kështu, të konsiderojmë nëse informacioni tjetër nuk është materialisht në kundërshtim me pasqyrat financiare ose me njohuritë tona të marra në auditim.

Në lidhje me raportin e menaxhmentit kemi marrë parasysh nëse ai përfshin shpalosjen e kërkuar nga Ligji Nr. 06 / L-032 për Kontabilitetin, Raportimin Financiar dhe Auditimin, Neni 10.

Bazuar, vetëm në punën që kërkohet të bëhet gjatë auditimit të pasqyrave financiare dhe procedurave të mësipërme sipas mendimit tonë:

Opinionin mbi raportin e Menaxhmentit

Bazuar në punën tonë të kryer gjatë auditimit, opinionin jonë është se raporti i Menaxhmentit:

- është përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 06 / L-032 për kontabilitetin, raportimin financiar dhe auditimin.

Opinion mbi Deklaratën e Qeverisjes Korporative

Në opinionin tonë, Deklarata e Qeverisjes Korporative të Organizatës i përmban të gjitha informacionet siç kërkohet nga neni 7 i ligjit dhe është në përputhje me informacionin e përfshirë në pasqyrat financiare.

Raport mbi kërkesat tjera ligjore dhe rregullative

Deklaratë në lidhje me ofrimin e shërbimeve jo të auditimit


Në më të mirën e njohurive dhe besimit tonë, ne sigurojmë që nuk kemi ofruar asnjë shërbim jo-auditues të cilat janë të ndaluara në Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2021 për Pavarësinë e Auditorëve Ligjorë dhe Firmave të Auditimit.



Emërimi i auditorit

Ne u emëruam si Auditor të Pasqyrave financiare te Organizatës me 21 Dhjetor 2022 përmes një procesi te tenderimit publik. Ne konfirmojmë se nga këndvështrimi i Ligjit Nr. 06 / L-032 për kontabilitetin, raportimin financiar dhe auditimin, ky është viti i parë qe ne po ofrojmë shërbime të auditimi për pasqyrat financiare te Kompanisë.

Audit & Conto,


Ymer Shatri
Partner Angazhimi
28 Prill 2023



AUDIT & CONT shpk

Rr. Simon Shiroka 11/4, 10000 Prishtina, Kosovë (tel +38344506702)


Email: auditconto@gmail.com

www.audit-conto.com

K.R.U. MITROVICA SH.A.
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
 Me 31 dhjetor 2022
 Të gjitha shumat në Euro


	Shënimi	Më 31 dhjetor 2022	Më 31 dhjetor 2021
PASURITË			
Pasuritë afatgjata			
Prona, pajisjet dhe impiantet	5	24,162,675	26,531,643
Investimet në vijim	5a	90,676	90,676
Gjithsej pasuritë afatgjata		24,253,351	26,622,319
Pasuritë afatshkurtra			
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	6	25,871,367	24,783,897
Stoqet	7	264,537	257,219
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	8	32,081	104,514
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		26,167,985	25,145,630
Gjithsej pasuritë		50,421,336	51,767,949
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	9	5,046,592	5,223,238
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		5,046,592	5,223,238
Detyrimet afatgjata			
Detyrimet e tjera afatgjata	10	17,900,881	19,156,437
Gjithsej detyrimet afatgjata		17,900,881	19,156,437
Gjithsej detyrimet		22,947,473	24,379,675
EKUITETI			
Kapitali aksionar	11	26,490,000	26,490,000
Fitimet e mbajtura		983,863	898,274
Gjithsej ekuiteti		27,473,863	27,388,274
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		50,421,336	51,767,949

Pasqyrat financiare janë përgatitur dhe aprovuar nga menaxhmenti i K.U.R. MITROVICA SH.A. dhe janë nënshkruar më 02 mars 2023 në emër të:


Bashkim Kurti

Kryeshef Ekzekutiv




Emine Peci Mahmuti

UD ZKF

Shënimet e bashkangjitura në faqet 9 deri 28 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

K.U.R. MITROVICA SH.A.
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022

Të gjitha shumat në Euro

		Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2022	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021
	<i>Shënimi</i>		
Të hyrat	12	5,139,898	4,778,721
Kostoja e shitjes	13	(659,702)	(517,465)
Fitimi / (humbja) bruto		4,480,196	4,261,256
Të ardhurat tjera	12	1,639,135	1,974,502
Shpenzimet e shpërndarjes	14	(2,480,465)	(2,516,381)
Shpenzimet e personelit	15	(1,998,927)	(1,897,698)
Shpenzimet administrative - Komunalitë	16	(737,272)	(731,213)
Shpenzimet administrative tjera	17	(797,921)	(1,931,697)
Fitimi / (humbja) operativ		104,745	(841,231)
Shpenzimet financiare	18	(19,157)	(98,462)
Të ardhurat financiare			
Fitimi / (humbja) para tatimit		85,589	(939,692)
Shpenzimet e tatimit në fitim	19		
Fitimi / (humbja) i/e vitit		85,589	(939,692)

Shënimet e bashkangjitura në faqet 9 deri 24 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

AUDIT & CONT shpk

Rr. Simon Shiroka 11/4, 10000 Prishtina, Kosovë (tel +38344506702)

Email: auditconto@gmail.com

www.audit-conto.com

K.U.R. MITROVICA SH.A.
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET
 Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022
 Të gjitha shumat Euro

	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2021	26,490,000	1,837,988	28,327,988
Fitimi / (humbja) i/e vitit		(939,693)	(939,693)
Ndryshimi në vitet e kaluara		(21)	(21)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	26,490,000	898,274	27,388,274
Fitimi / (humbja) i/e vitit		85,589	85,589
Gjendja më 31 dhjetor 2022	26,490,000	983,863	27,473,863

K.U.R. MITROVICA SH.A.
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022
Të gjitha shumat Euro

Për vitin që përfundon më 31 dhjetor	2022	2021
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi / (humbja) i / e vitit	85,589	(939,693)
Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave		
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	2,375,183	2,445,292
Shpenzimet financiare	19,157	98,462
	2,479,928	1,604,061
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative		
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	(1,087,470)	(14,126)
(Rritja) / zvogëlimi në stoqe	(7,318)	(17,577)
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	(176,647)	71,495
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera	(1,255,555)	(1,283,472)
	(2,526,990)	(1,243,680)
Tatimi në fitim i paguar		
Interesi i paguar	(19,157)	(98,462)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative	(19,157)	(98,462)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	(6,215)	(164,539)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese	(6,215)	(164,538)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese		
Ndryshimi në vitet e kaluara		(21)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese	-	(21)
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë	(72,433)	97,360
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	104,514	7,154
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	32,081	104,514

Shënimet e bashkangjitura në faqet 9 deri 24 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

K.R.U. MITROVICA SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Me 31 dhjetor 2022

Të gjitha shumat në Euro

1. Informata të përgjithshme

K.R.U. MITROVICA SH.A. është një shoqëri akcionare që u regjistrua në agjencinë e regjistrimit të bizneseve në Kosovë më 29 maj 2007 me numrin e regjistrimit të biznesit 70433740 dhe numër unik identifikues 810364852. Zyra qendrore e kompanisë është e vendosur në Mitrovicë, rr. Liqenit, p.n. Aktiviteti e kompanisë sipas Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë (ARBK):

Kodi	Përshkrimi	Tipi
3600	Grumbullimin, trajtimin dhe furnizimin me ujë	Primarë
4313	Testi i shpuarjes dhe shpuarja	Sekon

Gjatë vitit 2022 Kompania kishte mesatarisht 261 të punësuar (2021: 250 punëtorë).

Pronar i Kompanisë është Qeveria e Kosovës me 100% të aksioneve.

2. Baza e përgatitjes së pasqyrave financiare

a) Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Nderkombetare të Raportimit Financiar.

b) Bazat e matjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike. Kostoja historike në përgjithësi bazohet në vlerën e drejtë të vlerës së dhënë në këmbim të të mirave dhe shërbimeve.

c) Valuta funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Euro që është edhe valuta funksionale e kompanisë.

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-në kërkon që menaxhmenti të bëjë vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shifrat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen mbi baza të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

e) Parimi i vijueshmërisë

Pasqyrat e pozitës financiare dhe ajo e të ardhurave janë përgatitur mbi parimin e vijueshmërisë që supozon që kompania do të jetë në gjendje të realizojë pasuritë e saj dhe ti mbulojë detyrimet gjatë rrjedhës normale të biznesit.

K.R.U. MITROVICA SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Me 31 dhjetor 2022

Të gjitha shumat në Euro

3. Politika të rendësishme kontabël

a) Prona dhe pajisjet

(i) Njohja dhe matja

Zërat e pronës dhe pajisjeve janë paraqitur sipas kostonus minus zhvlerësimit të akumuluar dhe humbjeve nga dëmtimet.

Kosto përfshinë shpenzimet të cilat i atribuohen direkt blerjes së pasurisë.

Kur pjesët e një zëri të pronësimplanteve dhe pajisjeve kanë jetë të ndryshme të përdorimit ato trajtohen si zëra të veçantë (komponenta kryesore) të implanteve dhe pajisjeve.

Një zë i pronës dhe pajisjeve çregjistrohet në rast se shitet ose kur nuk ka përfitime të ardhme ekonomike që pritet të lindin nga përdorimi i vazhdueshëm i pasurisë. Çdo fitim ose humbje që krijohet me rastin e shitjes së një zëri të pronës implanteve dhe pajisjeve përcaktohet si diferencë midis të ardhurave nga shitja dhe vlerës kontabël neto të pasurisë dhe njihet në fitim ose humbje.

(ii) Kostot pasuese

Kosto e zëvendësimit të një pjese të pronës dhe pajisjeve njihet sipas vlerës bartëse të zërit nëse përfitimi i ardhshëm ekonomik i integruar mbrenda pjesës së pasurive është i mundshëm të rrjedhë në kompani dhe kosto e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e servisimit të pronës dhe pajisjeve nga dita në ditë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes kur ato ndodhin.

(iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes sipas metodës lineare përgjatë jetës së vlerësuar të përdorimit të pasurive. Metodat e zhvlerësimitjetët e përdorimit dhe vlerat e mbetura (nëse nuk janë domethënëse) rivlerësohen në datën e raportimit.

Jetët e vlerësuar të përdorimit për periudhat e tanishme dhe krahasuese ishin siç vijon;

Përshkrimi	Norma vjetore
Mjete transporti	20%
Makineri e vegla pune	20%
Pajisje informatike & Software	20%
Mobilje e orendi	20%

b) Pasuritë financiare

Të gjitha blerjet ose shitjet në mënyrë të rregullt të pasurive financiare njihen dhe çregjistrohen në bazë të datës së tregtisë. Blerjet ose shitjet në mënyrë të rregullt janë blerje ose shitje të pasurive financiare që kërkojnë shpërndarjen e pasurive mbrenda afatit kohor të përcaktuar me rregullore ose konventë në treg.

Të gjitha pasuritë e njohura financiare maten më pas në tërësi ose me koston e amortizuar ose me vlerën e drejtë të varësi të klasifikimit të pasurive financiare.

Klasifikimi i pasurive financiare

Instrumentet e borxhit që plotësojnë kushtet e mëposhtme maten më pas me koston e amortizuar:

- Pasuria financiare mbahet mbrenda një modeli biznesi qëllimi i të cilit është të mbajë pasuritë financiare për të mbledhur flukset monetare kontraktuale; dhe
- Kushtet kontraktuale të pasurisë financiare lindin në data të specifikuar të fluksit të parave që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi shumën kryesore të papaguar.

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

c) Pasuritë financiare (vazhdim)

Instrumentet e borxhit që plotësojnë kushtet e mëposhtme maten më pas me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDPATGJ):

- Pasuria financiare mbahet brenda një modeli biznesi objektivi i të cilit arrihet nga të dyja mbledhjet e flukseve monetare kontraktuale dhe shitja e pasurive financiare; dhe
- Kushtet kontraktuale të pasurisë financiare lindin në data të përcaktuara flukset e parave që janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi shumën kryesore të papaguar.

Të gjitha pasuritë e tjera financiare maten më pas me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDPFH). Përkundër kësaj më sipërkompania mund të bëjë zgjedhjet / përcaktimin e pakthyeshmë të mëposhtëm në njohjen fillestare të një pasurie financiare:

- Kompania mund të zgjedhë në mënyrë të pakthyeshme për të paraqitur ndryshime të mëvonshme në vlerën e drejtë të një investimi në kapital në të ardhura të tjera gjithëpërfshirësenëse përmbushen kriteret të caktuara (shiko më poshtë); dhe
- Kompania mund të përcaktojë në mënyrë të pakthyeshme një investim borxhi që plotëson koston e amortizuar ose kriteret e VDPATGJ të matura në VDPFH nëse duke bërë kështu eliminon ose zvogëlon ndjeshëm një mospërputhje të kontabilitetit (shiko më poshtë):

(i) Kostoja e amortizuar dhe metoda efektive e interesit

Metoda efektive e interesit është një metodë e llogaritjes së koston së amortizuar të një instrumenti borxhi dhe shpërndarjes së të ardhurave nga interesi për periudhën përkatëse.

Për pasuritë financiare përveç pasurive financiare të cilat kanë rënë në vlerëtë blera ose të gjeneruara përbrenda portfolios së kompanisë (d.m.th. pasuritë të cilat janë të dëmtuara nga kredia në njohjen fillestare) norma efektive e interesit është norma që saktësisht zbrit vlerat e arkëtimeve të vlerësuara në të ardhmen (përfshirë të gjitha tarifatat e paguara ose pranuar që formojnë një pjesë integrale të normës efektive të interesitkostonve të transaksionit dhe primeve ose zbritjeve të tjera) duke përjashtuar humbjet e pritura të kredisëpërgjatë jetës së pritshme të instrumentit të borxhitosekur është e përshtatshmenjë periudhë më të shkurtërnë vlerën kontabël bruto të instrumentit të borxhit në njohjen fillestare. Për pasuritë financiare që kanë rënë në vlerëtë blera ose të gjeneruara përbrenda portfolios së kompanisënjë normë efektive interesi e rregulluar nga kredia llogaritet duke zbritur flukset e vlerësuara të parasë së ardhshme përfshirë humbjet e pritura të kredisënë koston e amortizuar të instrumentit të borxhit në njohjen fillestare.

Kostoja e amortizuar e një pasurie financiare është shuma në të cilën pasuria financiare matet në njohjen fillestare minus ripagimet e kryeraplus amortizimin kumulativ duke përdorur metodën e interesit efektiv të çdo ndryshimi midis asaj shume fillestare dhe shumës së maturimit të rregulluar për çdo humbje kompensimi. Vlera kontabël neto e një pasurie financiare është kostoja e amortizuar e një pasurie financiare para se të rregullohet për çdo rënie në vlerë.

Të ardhurat nga interesi njihen duke përdorur metodën e interesit efektiv për instrumentet e borxhit të matur më pas me koston e amortizuar dhe në VDPATGJ. Për pasuritë financiarepërveç pasurive financiare të rëna në vlerëtë blera ose të gjeneruara mbrenda portfolios së kompanisë të ardhurat nga interesi llogariten duke aplikuar normën efektive të interesit në vlerën kontabël bruto të një pasurie financiarepërveç pasurive financiare që më pas kanë rënë në vlerë (shiko më poshtë). Për pasuritë financiare që kanë rënë në vlerëtë ardhurat nga interesi njihen duke aplikuar normën efektive të interesit në koston e amortizuar të pasurisë financiare.

K.R.U. MITROVICA SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Me 31 dhjetor 2022

Të gjitha shumat në Euro

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

c) Pasuritë financiare (vazhdim)

Fitimet dhe humbjet e këmbimit valuator

Vlera kontabël e pasurive financiare të shprehura në një valutë të huajpërcaktohet në atë valutë të huaj dhe të konvertuara në kursin e këmbimit në fund të cdo periudhe raportuese. Specifikisht:

- Sasia kontabël e pasurisë financiare që janë të shprehura në një valutë të huaj përcaktohet në atë valutë të huaj dhe të përkthyer në kursin e pikës në fund të çdo periudhe raportimi. Në mënyrë të veçantë për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar që nuk janë pjesë e një marrëdhënieje të caktuar të mbrojtjesdiferencat e këmbimit njihen në fitim ose humbje në zërin tjetër të fitimeve dhe humbjeve;
- Për instrumentet e borxhit të matur në VDPATGJ që nuk janë pjesë e një marrëdhënieje të caktuar të mbrojtjesdiferencat e këmbimit në koston e amortizuar të instrumentit të borxhit njihen në fitim ose humbje në zërin tjetër të fitimeve dhe humbjeve. Diferencat e tjera të këmbimit njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse në rezervën e rivlerësimit të investimeve;
- Për pasuritë financiare të matura në VDPFH që nuk janë pjesë e një marrëdhënieje të caktuar të mbrojtjesdiferencat e këmbimit njihen në fitim ose humbje në zërin e "fitimeve dhe humbjeve të tjera"; dhe
- Për instrumentet e kapitalit të matur në VDPATGJ diferencat e këmbimit njihen në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse në rezervën e rivlerësimit të investimeve.

Çregjistrimi i pasurive financiare

Kompania çregjistron një pasuri financiare vetëm kur skadojnë të drejtat kontraktuale të fluksit të parave nga pasuria ose kur transferon pasurinë financiare dhe në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurisë në një entitet tjetër. Nëse Kompania nuk transferon dhe nuk mban në masë të madhe të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe vazhdon të kontrollojë pasurinë e transferuarkompania njeherë interesin e saj të mbajtur një pasuri dhe një detyrim shoqëruar për shumat që mund të duhet të paguajë.

Për çregjistrimin e një pasurie financiare të matur me koston e amortizuar diferenca midis vlerës kontabël të pasurisë dhe shumës së vlerës së marrë dhe të arkëtueshme njihet në fitim ose humbje. Përveç kësaj çregjistrimin e një investimi në një instrument borxhi të klasifikuar si në VDPATGJ fitimi ose humbja kumulative e grumbulluar më parë në rezervën e rivlerësimit të investimeve është riklasifikuar në fitim ose humbje.

(i) Rritjet e konsiderueshme në rrezikun kreditorë

Në vlerësimin nëse rreziku i kredisë në një instrument financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare kompania krahason rrezikun e një mospagimi që ndodh në instrumentin financiar në datën e raportimit me rrezikun e një mospagimi të ndodhur në instrumentin financiar në datën e fillestare të njohjes. Për këtë vlerësim kompania konsideron si informacionin sasior ashtu edhe atë cilësor që është i arsyeshëm dhe i mbështetshëm përshirë përvojën historike dhe informacionin e ardhshëm që është në dispozicion pa kosto ose përpjekje të panevojshme. Informacioni i ardhshëm marrë në konsideratë përfshin perspektivën e ardhshme të industrive në të cilat veprojnë debitorët e kompanisë të marra nga raportet e ekspertëve ekonomikë analistët financiarë organet qeveritare dhe organizatat e tjera të ngjashme dhe shqyrtimin e burimeve të ndryshme të jashtme që parashikojnë informacione ekonomike që kanë të bëjnë me operacionet thelbësore të kompanisë.

Në veçanti informacioni i mëposhtëm merret parasysh kur vlerësohet nëse rreziku i kredisë është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare:

- Një përqësim i dukshëm aktual ose i pritshëm i vlerësimit të jashtëm të instrumentit financiar (nëse është i disponueshëm) ose i brendshëm i kredisë;
- Përqësim i ndjeshëm i treguesve të tregut të jashtëm të rrezikut të kredisë për një instrument të veçantë financiar p.sh. një rritje e konsiderueshme në përhapjen e kredisë çmimet e këmbimit të parazgjedhur të kredisë për debitorinose kohëzgjatjen ose masën në të cilën vlera e drejtë e një aktivi financiar ka qenë më pak se kostoja e tij e amortizuar;

AUDIT & CONT shpk

Rr. Simon Shiroka 11/4, 10000 Prishtina, Kosovë (tel +38344506702)

Email: auditonto@gmail.com

www.audit-conto.com

K.R.U. MITROVICA SH.A.
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE

Me 31 dhjetor 2022

Të gjitha shumat në Euro

3. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

c) Pasuritë financiare (vazhdim)

